## SYLLABUS I LËNDËS

| Të dhënat bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **FAKULTETI I AGROBIZNESIT** |
| **Titulli i lëndës:** | **Inovacioni dhe ndërmarrësia për sisteme të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit** |
| **Niveli:** | **Master** |
| **Statusi lëndës:** | **Zgjedhore** |
| **Viti i studimeve:** | **I** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+2** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **5** |
| **Koha / lokacioni:** | **Të Hënën 09:45-12:00** |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. Dr. Halit Shabani** |
| **Detajet kontaktuese:** | **Halit.shabani @unhz.eu** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Lënda është e dizajnuar në mënyrë të tillë që të ju ofrojë studetnëve të kuptuarit teorik dhe empirik mbi inovacionin dhe ndërmarrësinë për systemin e qëndrueshëm të prodhimeve ushqimore. Për më tepër, lënda do të njohë studentët me hapat që duhet te ndërmerren gjatë procesit të realizimit të ideve sipërmarrëse dhe vlerësimit të burimeve të nevojshme për t'i realizuar ato me sukses në sektorin e prodhimit të ushqimit, me fokus në parimet e qëndrueshmërisë sociale, ekonomike dhe mjedisore. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Qëllimi i kësaj lënde është të pajisë studentët me konceptet dhe parimet që lidhen me inovacionin si dhe t'i vetëdijësojë ata mbi rëndësinë e inovacionit dhe sipërmarrjes për zhvillimin në nivel individual, të biznesit, sektorit dhe shoqërisë. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:<br><br>- Njohin termat në fushën e inovacionit<br>- Njohin rëndësinë e inovacionit dhe ndërmarrësisë për zhvillimin e bizneseve dhe ekonomisë në tërësi;<br>- Dallojnë ndryshimin ndërmjet inovacionit dhe shpikjes dhe të adoptojnë principet etike të biznesit në fushën e inovacionit;<br>- Definojnë kornizën ligjore për nismat ndërmarrëse në sektorin ushqimor dhe sa zgjasin këto procedura;<br>- Aplikojnë metoda për të analizuar rezultatet ekonomike në nismat ndërmarrëse;<br>- Vlerësojnë përshtatshmërinë e burimeve ekzistuese në tregun kapital për ndërmarrësit e prodhimeve ushqimore; |

| **Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 | 30 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Punë praktike | / | / | / |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 2 | 2 | 4 |
| Ushtrime  në teren | / | / | / |
| Kollokfiume, seminare | 1 | 11 | 11 |
| Detyra të  shtëpisë | / | / | / |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 10 | 20 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 15 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 1 | 10 | 10 |
| Projektet,prezantimet ,etj | 1 | 5 | 5 |
| **Totali** | | | **125** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | • *Ligjërata interaktive*<br>• Prezantime të studentëve<br>• Diskutime,<br>• Raste studimi,<br>• Projekte në grup dhe studim të projektit,<br>• Përdorimin e aplikacioneve softverike,<br>• *Konsultimet, etj.*<br>Të gjitha detyrat duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike dhe në kopje fizike. |
| **Metodat e vlerësimit:** | Procesi i vlerësimit konsiston në: |

| **Detyrat** | **% e notës** |
|---|---|
| Prezentimi verbal - Aktiviteti gjatë ligjëratës | 10% |
| Pjesëmarrja dhe kontrolli i koncepteve | 10% |
| Projekti | 20% |

| | |
|---|---|
| Testi i parë | 20% |
| Provimi Final (Cumulative) | 40% |
| Totali | 100% |

Çdo student do të vlerësohet në fund të semestrit në bazë të pikëve të grumbulluara gjatë semestrit (Testi i parë, prezantimi/et me gojë), pjesëmarrja, projekti dhe provimi final).

Testi dhe provimi finale (teori dhe ushtrime) mund të përfshijnë:

- Pyejte me përgjigje të shumëfishta
- Zhvillim të shkurtër të një teksti (ese)
- Ushtrim/ zgjidhje e një problem
- Aplikime softverike

Shkalla e vlerësimit:

| Përqindja e notës | Nota |
|---|---|
| 90 – 100% | 10 |
| 80 – 89% | 9 |
| 70 – 79% | 8 |
| 60 – 69% | 7 |
| 50 – 59% | 6 |
| 0 – 49% | 5 |

**Literatura**

**Literatura bazë:**

1. Ognjenović, Dragana (2019): teaching material, ppt
2. Ministarstvo gospodarstva Republike Hrvatske (2008): Poslovni plan poduzetnika, Masmedia, Zagreb.
3. Čovo, P. (2007): Održivo poduzetništvo (skripta), Univerzitet u Zadru.

**Literatura shtesë:**

1. Orsag, S. (2010): Budžetiranje kapitala – Procjena investicijskih projekata, Masmedia,Zagreb.

**Plani i dizajnuar i mësimit:**

| **Java** | **Ligjërata që do të zhvillohet** |
|---|---|
| ***Java e parë:*** | Prezantimi i përmbajtjes dhe detyrime të lëndës. |

| | |
|---|---|
| ***Java e dytë:*** | Termat bazë dhe definicionet: zbulimi, shpikja, risia, inovacioni, kufizimet, etikat e biznesit. |
| ***Java e tretë*:** | Ndërmarrësia: termat, format, llojet. |
| ***Java e katërt:*** | Konceptet e qëndrueshmërisë së sipërmarrjes, principet dhe elementët. |
| ***Java e pestë:*** | Elementët e planit të biznesit. |
| ***Java e gjashtë*:** | Analiza e tregut. |
| ***Java e shtatë:*** | Lokacioni dhe analiza e kapaciteteve, provimi i semestrit të parë. |
| ***Java e tetë:*** | Analiza e procesit teknologjik të sipërmarrjes. |
| ***Java e nëntë:*** | Analiza e burimeve të nevojshme. |
| ***Java e dhjetë:*** | Analiza e tregut kapital. |
| ***Java e njëmbëdhjetë*:** | Analiza ekonomike e sipërmarrjes së ndërmarrjes. |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Metodat e vlerësimit të profitabilitetit. |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | Analiza e ndjeshmërisë, analiza e qëndrueshmërisë. |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | Zgjedhja e përbashkët e sipërmarrjes ekskluzive |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | Shënimë përmbyllëse, prezantim të detyrave të studentit |
| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** | |
| Sjellja në klasë nuk duhet të ndërhyjë në aftësinë e instruktorit për të udhëhequr mësimin ose në aftësinë e studentëve për të mësuar nga programi udhëzues. Sjellja e papranueshme dhe shqetësuese nuk do të tolerohet. Studentëve të cilët shqetësojnë ambientin mësimor do ju kërkohet të lëshojnë klasën dhe mund të jenë subjekt i dënime ligjore, akademike apo dënimeve të tjera. Këto ndalesa përfshijnë të gjitha forumet mësimore, duke përfshirë ato elektonike, në klasë, në laborator, grupet e diskutimit, udhëtime në terren, etj. Instruktori duhet të ketë lirinë e plotë mbi cfarë sjellje të përshtatshme apo të papërshtatshme do të ketë në sallë. Studentët të cilët nuk marrin pjesë në mësim ose kanë performancë të dobët do të jenë pjesë e programit peer to peer. Ky program rekomandon mësim shtesë dhe asistencë në mënyrë që këta studentë të kenë sukses. | |